REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

"DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029 TË BASHKISË SHKODËR"

Konsultim publik : Njësia administrative: Rrethina, Pult, Shosh, Shalë.

Data : *11.09.2026* **Ora** : *13.00* **Vendi:** *Pranë Komunës*

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesmarrësve 44, nga të cilat 2 gra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft-projekt planin buxhetor afatmesem 2027-2029 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- Projekt-aktin e propozuar
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve

I. Paraqitja e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe projektbuxhetit

Takimi u hap nga **z. Oltion Luli,** Kryetar i Këshillit Bashkiak Shkodër, i cili sqaroi se qëllimi i këshillimit ishte marrja e mendimeve dhe propozimeve të banorëve për nevojat dhe prioritetet që duhet të reflektohen në planifikimin buxhetor të vitit 2027 dhe në PBA 2027-2029.

Në paraqitje u kërkua që diskutimet të fokusoheshin te funksionet dhe shërbimet e Bashkisë Shkodër, përfshirë infrastrukturën rrugore, ndriçimin publik, pastrimin dhe menaxhimin e mbetjeve, ujësjellës-kanalizimet, kanalet kulluese e vaditëse, objektet arsimore dhe shëndetësore, shërbimet sociale dhe nevojat e tjera të komunitetit. Pjesëmarrësit u ftuan të përcaktonin prioritetet kryesore për zonat e tyre.

Z. Alban Preka, nënkryetar i Bashkisë Shkodër, përmblodhi disa nga ndërhyrjet e realizuara në infrastrukturë, ndriçim, kanale, shkolla e kopshte në zonat përkatëse dhe theksoi se nevojat mbeten të shumta, ndaj kërkohej prioritarizimi i kërkesave për planifikimin e mëtejshëm.

II. Diskutimet, kërkesat dhe propozimet

Z. Fatjon Likaj, banor i fshatit Dobraç: Kërkoi informacion për fillimin e investimit në rrugën "Isa Jakupi" dhe në rrugën "Mikel Kopsaj", për të cilën ishte përfunduar projektimi. Ngriti gjithashtu gjendjen e rënduar të tarracës së kopshtit të Dobraçit dhe nevojën për mirëmbajtje.

Z. Ardjan Troja, banor i Golemit: Falënderoi për ndërhyrjet e kryera, por evidentoi si problem furnizimin me ujë të pijshëm dhe gjendjen e shkollës së Golemit, me lagështi, suvatime e tualete të amortizuara.

Z. Vesel Dushaj, banor i Dobraçit të Ri: Kërkoi ndërhyrje në rrugën e Dobraçit të Ri, rreth 600 m, që lidhet me bypass-in, duke theksuar se zona me mbi 80 familje ka mungesë investimesh. Ngriti gjithashtu çështjet e ujësjellësit, qendrës shëndetësore dhe vonesave në procesin e legalizimeve.

Përfaqësues nga Bardhaj: Kërkoi trajtimin e rrugës së Gjyrezve dhe rrugës së Bregut të Kirit, si dhe asfaltimin e një rruge që u shërben rreth 50 familjeve.

Banorë/përfaqësues të zonës Grudë-Guci: Ngritën mungesën e ujit të pijshëm dhe vaditës, vonesat në legalizime, nevojën për përfshirjen e Grudës dhe Mesit në linjën urbane, si dhe ndërhyrjen në rrugën nga Fusha e Aviacionit deri në kryqëzimin e Gucisë. U evidentua edhe mungesa e energjisë elektrike në fshatin Brucaj.

Z. Sytki Haxhija, Shtoj i Vjetër: Kërkoi ndërhyrje në shkollën e Shtojit të Vjetër, të cilën e përshkroi si të amortizuar dhe me nevojë për rikonstruksion.

Z. Lulash Nika, banor i fshatit Hot i Ri: Kërkoi investime në rrugët Lulaj, Vllaznimi dhe Besëlidhja, si dhe shtimin e ndriçimit publik në fshat.

Z. Mir Qershija, banor i zonës Dobraç: Ngriti dëmtimet e rrugëve dhe trotuareve pas ndërhyrjeve të ujësjellësit, gjendjen e rrugës Myzyrej dhe rrugës kryesore të Dobraçit, si dhe nevojën për më shumë investime në shkolla dhe infrastrukturën e zonës.

Z. Taulant Shahmani: Kërkoi që çdo vit të përcaktohen prioritete të reja pasi realizohen ndërhyrjet e mëparshme. Evidentoi si kërkesa urgjente rrugën hyrëse për Guci të Re, ndërhyrjet në shkollën e Shtojit të Vjetër, sistemimin e këndeve sportive dhe përmirësimin e infrastrukturës së kopshteve, duke propozuar të realizohet të paktën një prioritet për çdo fshat.

Z. Lec Pali, nga zona e Shalës: Evidentoi si urgjente përmirësimin e rrjetit të energjisë elektrike, shtrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, si dhe nevojën për një fadromë që të jetë e disponueshme për ndërhyrjet e vazhdueshme në zonë.

Kryetari i fshatit Zues: Kërkoi ndërhyrje në dy rrugë të fshatit, disiplinimin e kanalizimeve të ujërave të zeza dhe asfaltimin e segmentit poshtë fabrikës së çimentos që lidhet edhe me varrezat dhe krijon akses alternativ në raste emergjencash.

Z. Lek Pepniku, kryetar i fshatit Nderlysaj: Ngriti nevojën për përmirësimin e energjisë elektrike dhe ujësjellësit, si dhe problematikat e regjistrimit të pronësisë dhe legalizimeve.

Z. Pal Shytani, kryetar i fshatit Gimaj: Kërkoi ndërhyrje urgjente në rrjetin elektrik, riparimin e rrugës së makinës që lidh dy fshatra, ndërtimin e një ure në lagjen Xhaferraj, trajtimin e dokumentacionit të pronësisë, mbështetje për zëvendësimin e mbulesave me eternit dhe fonde për kullat e vjetra.

Përfaqësues të Njësisë Administrative Shosh: Kërkuan ndërhyrje në Urën e Pejës dhe Urën e Brashtës.

Znj. Mirela Mataj: Kërkoi që shkollat të trajtohen si prioritet dhe të parashikohen investime në objektet arsimore të njësisë.

Drejtuesi i shkollës "Haxhi Hajdari", Golem: Evidentoi mungesën e mirëmbajtjes së godinës për një periudhë të gjatë dhe nevojën për ndërhyrje, si dhe problematikën e transportit të nxënësve.

III. Evidentimi i prioriteteve dhe dokumentacioni

1. Furnizimi me ujë të pijshëm dhe përmirësimi i rrjeteve të ujësjellësit në Golem, Grudë-Guci, Dobraç dhe zonat malore.
2. Rikonstruksioni dhe mirëmbajtja e rrugëve prioritare, përfshirë rrugët në Dobraç, Hot i Ri, Guci, Bardhaj, Shalë, Shosh dhe fshatrat e Pultit.
3. Përmirësimi i rrjetit elektrik dhe ndriçimit publik, veçanërisht në Shalë, Pult, Hot i Ri, Brucaj dhe zonat rurale.

4. Investime në shkolla dhe kopshte, përfshirë Golemin, Shtojin e Vjetër dhe infrastrukturën e kopshteve.
5. Ndërhyrje në kanalizime, kanale kulluese/vaditëse, ura dhe akseset e emergjencës.
6. Përmirësimi i transportit publik dhe transportit të nxënësve, si dhe adresimi i legalizimeve dhe regjistrimit të pronësisë.
7. Parashikimi i një mekanizmi për ndërhyrje të shpejta me makineri në zonat malore dhe realizimi, sa të jetë e mundur, i të paktën një prioriteti për çdo fshat.

Kërkesat, vërejtjet dhe propozimet e mësipërme administrohen si pjesë e dokumentacionit të këshillimit publik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe projektbuxhetin vjetor 2027. Ato pasqyrojnë ndërhyrjet dhe prioritetet e paraqitura gjatë takimit dhe nuk përbëjnë vendimmarrje të pjesëmarrësve.

SEKRETARE

Sabina Danaj

Zbardhi proces verbalin:

Bekim Mema

Irma Sulishti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË PREZENCË

KONSULTIM PUBLIK: ***" PËR DRAFT PROJEKT PLANIN BUXHETOR AFATMESEM 2027-2029 TË BASHKISË SHKODËR"***

Njësia Administrative Rrethina, Pult, Shosh, Shalë ***Datë: 11.09.2026***

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
1.	Ismet Rakova		Shtigjiri		
2.	Sabri Sulja	0676305032	Golem		
3.	Mentor Kulla	0695422300			
4.	GJERGJ NIKA	069 5580000	B. SHKODER	nikagjergj63@gmail.co	
5.	Vitorio Plumbaj	0676733111	Hotiri		
6.	Mikel Mapaj	0676221911	B. Shkodra		
7.	Adit Beheri	0682484025	B. Shkodra	Adit.Beheri@bashkiashkoder.gov.al	
8.	Azim Salihi	0682092990	B Shkodra	azimsalihi@yahoo.com	
9	Dhorotea Lalaj	0673574001	B. Shkodra	dhorotealalaj@bashkiashkoder.gov.al	

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
10.	Viktor Skeldja	0696411374	DPMOP	Viktor.skeldja@bashkia-sk.gov.al	
11	Bexhet Ejhoraj	0672854382	JW		
12.	Ahmet Vefaraj	Fus	0692341608	-	
13.	Javelin Gropaj	Gjadër	0682574110		
14.	Pol Shytaraj	Gimaj	0682374479		
15.	Çerçiz Prenkaj	Ndërlysa	0685003339		
16.	FATBARDH DAMA	GOLEM	0692506382	damafatbardh@gmail.com	
17.	Sytki Hoxhaj	Shtog fjalor	0672074286		
18.	Arbit Abdyli	Bardhaj			
19.	Melsor Abdyli	Bardhaj			
20.	Dakë Çezma	Ny SHOSH	068315351		
21.	Pashko-Shpati	Bombaj			
22.	HARIS ABDYLI	BARDHAJ			
23.	ORJET ABDYLI	BARDHAJ			
24.	Leq Luca				
25.	Xhel Gjela				
26.	Drel Krani				
27.	Vati Verri		0694538814		
28	Leola Berisha	Theth	0688126000		
29.	Plumb-Sonja	Lekaj	0684142882		

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
30.	Ylli PREKE	DGMAJ	Burrel	0695532701	
31.	Fllamb Odri	Xhan	Xhan	0683398242	
32.	Lulash Niko	Hot i Ri	Hot i Ri	068203499	
33.	ARDIAN TAOJA	GOLEM		0698881808	
34.	Elida Deliu	Hot i Ri			
35.	FITIM BUHAJ	GOLEM	0692525554		
36.	Drita Alija	Dobraç	0692259645		
37.	Nduc Dedaj	Hot i Ri	0692073124		
38.	Frederik Shelna	Hot i Ri	0674828148		
39.	Bashkim Bacaj	Shtoj i Ri	0693206533		
40.	Arbit Tefaj	Dobraç	0692595761		
41.	Ilyetin Shehu	Tenoj-N	067255605		
42.	Ermal Spahiu	Shtoj i Vjetër	0692388994		
43.	Taulant Shahini	Gac e Re	0695412242		
44.	Besnik Nuredini	Dobroshi Ri	067716166		
45.					
46.					
47.					
48.					
49.					